



GJYKATA SUPREME E KOSOVES
VRHOVNOG SUDA KOSOVA
DHOMA E POSAÇME
SPECIJALNA KOMORA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

II
Br. 3772
No. 3
Nr i fq. 3
Br.Str. 3
No. pg. 3

Date: 24. 06. 2026
Date: 24. 06. 2026
Prishtinë / Pristina

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
---	--	---

Numëri i lëndës:	C-IV.-24-0074	Data:	19.06.2026
Titulli i dokumentit		Data e dokumentit	
AKTVENDIM		18.06.2026	

Pala	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT <i>Rr. Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte, Prishtinë.</i>
Pranuar nga:	
Titulli:	
Data e pranimit:	
Nënshkrimi	

G.P





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:127303

Datë: 18.06.2026

Numri i dokumentit: 09060396

C-IV-24-0074

Parashtruesi

Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit i GJI141 KB “Glloboçica”
(Në likuidim) FI-204/85 , Lagja Lakërishtë rruga “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Kërkesa:

Aplikimi për të marr leje nga Dhoma e Posaçme për të hequr dorë nga aset i P-70917018-00684-5
ZK Qafëshqipja-Kaçanik, parcelë e regjistruar në emrin e GJI141, KB ” Glloboçica“

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS për çështjet në lidhje me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren kryesuese Ganimete
Puka, si dhe anëtarët e kolegjit Diellza Hoxha dhe Hasim Sogojeva, në seancën vendimmarrëse,
me 16 Qershor 2026, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET kërkesa Autoritetit të Likuidimit GJI141 KB” Glloboçica “ (në likuidim)
dhe i LEJOHET heqja dorë nga aset i P-70917018-00684-5 ZK Qafëshqipja-Kaçanik, parcelë e
regjistruar në emrin e GJI141, me sipërfaqe prej 265 m2, pronë KB” Glloboçica”.

2. Nuk caktohen taksa gjyqësore .

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më datë 29.04.2024, parashtruesi Autoriteti i Likuidimit – Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka
parashtruar kërkesë me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të merr vendim me të cilin do t'i
lejohet heqja dorë nga aset i qe është pronë e KB “Glloboçica”, me nr GJI141, P-70917018-
00684-5 ZK Qafëshqipja-Kaçanik, parcelë e regjistruar në emrin e GJI141, me sipërfaqe prej
265 m2, pronë KB” Glloboçica”.



Numri i lëndës: 2024:127303
Datë: 18.06.2026
Numri i dokumentit: 09060396

Parashtruesi kërkesën e mbështetet në faktin se sipas shtojcës së ligjit 04-L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit me leje të gjykatës mund të heq dorë nga një aset për rastet si në vijim:

1. Neni 18 par 3.1 i Shtojcës së Ligjit të lartpërmendur parasheh rastet kur aset i është problematik apo jo profitabil dhe i cili sipas mendimit të arsyeshëm të AL-së, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe
2. Neni 18 par 3.2 i po të njëjtit ligj për AKP-në përcakton se mund të hiqet dorë nga çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të AL-së nuk mund të ushtrohet kontrolli efektive nga ana e ndërmarrjes, AL-së apo gjykatës. Duke pas parasysh mendimin e arsyeshëm AL-ja konsideron se aset i është jo profitabil dhe nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe për këtë arsye AL-ja aplikoj te Dhoma e Posaçëm që të jep lejen për të heq dorë nga aset.

Për më tepër edhe neni 3 paragrafi 10, pika 4 i Rregullores nr. 8/2023 për Politika dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, parashihet që *‘Duke iu nënshtruar aprovimit të DHPGJS -së të kërkesës të cilën AL-ja ia parashtron asaj, AL-ja mund të heqë dorë prej një asemi ose disa asetëve të NSH-së në rrethana të caktuara sipas nenit 18.3.1 dhe 18.3.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Po ashtu në këtë nen përcaktohet edhe që të gjitha kërkesat për heqje dorë të asetëve paraprakisht miratohen nga Bordi i Drejtorëve para se të dorëzohen në Dhomën e Posaçme sipas ligjit.*

Po ashtu iniciimi i procedurës për heqje dorë nga këto asete bëhet edhe në bazë të nenit 4 par.1 i Rregullores nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të asetëve. Duke qenë se këto parcela shfrytëzohen si varreza, atëherë konform nenit 7 par.1 të kësaj rregullore është kërkuar konfirmimi nga ana e autoriteteve lokale për të japur komentet e tyre në lidhje me destinimin apo shfrytëzimin e parcelave.

Sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, asetet janë jo profitabil dhe nuk janë në gjendje të kenë realizim fitimprurës dhe për këtë arsye, ashtu si është sqaruar më detajisht në arsyetimin më poshtë, AL aplikon te kjo gjykatë ti jap lejen për të hequr dorë nga asetet.

Parashtruesi tutje ka shtuar se duke pas parasysh që parcela nr. P-70917018-00684-5, ZK Qafëshqipja-Kaçanik, me sipërfaqe prej 265 m2, shfrytëzohet si varreza. Autoriteti i Likuidimit erdhi në përfundim që aset i nuk është jo-profitabil dhe nuk është në gjendje të realizimit fitimprurës dhe tani më ka marrë edhe miratimin nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë për të hequr dorë nga ky aset .

Pas aprovimit të kësaj kërkesë të AL-së nga ana e DHPGJS, atëherë në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore , i cili specifikon që ‘ në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një paluajtshmëri, atëherë pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent’

Andaj duke u bazuar në faktet dhe arsyet të paraqitura si më lartë, Autoriteti i Likuidimit i kërkon Dhomës së Posaçme të marrë leje për të hequr dorë nga asetet nr. parcelat nr. P-70917018-00684-5 me sipërfaqe totale prej 265 m2, ZK Qafëshqipja-Kaçanik, siç përshkruhet në certifikatën nr. 37123/24 të datës 24.01.2024.

Arsyetimi ligjor

Aprovohet kërkesa e AL-së dhe i lejohet të njëjtës të heqë dorë nga aseti nr. P-70917018-00684-5, ZK Qafëshqipja-Kaçanik, me sipërfaqe prej 265 m2, siç përshkruhet në certifikatën nr. 37123/24 të datës 24.01.2024.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Autoritetit të Likuidimit me të cilën ka kërkuar që ti aprovohet e njëjta dhe ti lejohet heqja dorë nga aseti nr. P-70917018-00684-5, ZK Qafëshqipja-Kaçanik, me sipërfaqe prej 265 m2, siç përshkruhet në certifikatën nr. 37123/24 të datës 24.01.2024.e regjistruar në emrin e GJI141, KB "Gllloboçica", e në lidhshmëri me nenin 18 par.3.1 dhe 3.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Gjykata gjeti se me të drejtë parashtruesi ka kërkuar që ti lejohet heqja dorë nga aseti.

Duke u bazuar në nenin 18 par.3. të shtojcës së Ligjit nr.04L-034, të AKP/së, i cili parasheh se Autoriteti i Likuidimit, me leje të Gjykatës mund të heqë dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes në vijim: *3.1 çdo aset problematik apo joprofitabil i cili sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës; 3.2 çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrje, Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës, nga kjo rezulton se kërkesa e Autoritetit të Likuidimit është e bazuar.me të drejtë ka kërkuar .*

Bazueshërin e kërkesës Gjykata e mbështeti në arsyetimet e dhëna nga parashtruesi i cili ka theksuar së ky asete /parcela nuk është profitabile apo fitimprurëse, parcela kadastrale nr. P-70917018-00684-5, ZK Qafëshqipja-Kaçanik, me sipërfaqë prej 265 m2,, shfrytëzohet si varreza.

Andaj nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 18 par. 4 të shtojcës së Ligjit 04-L-034 për AKP/në, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore:Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike:Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimet Duka, Gjyqtare kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare anëtare

Hasim Sogojeva, Gjyqtar anëtar